

PRANUAR ME: 29.01.2026
ACCEPTED ON:
PRIMLJENO:
Nr.Ng.Dr: 27/11



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E MALISHEVËS
Drejtoria e Inspektoratit

DATË	29/01/2026
PËR:	z. Ekrem KASTRATI , Kryetar i Komunës
NGA:	Bardhyl BUÇAJ, Shef në Drejtorinë e Inspektoratit
LËNDA:	Raport i Punës së Drejtorisë së Inspektoratit për periudhën kohore prej 01/01/2025 deri 31/12/2025



I nderuar,

Bashkangjitur gjeni Raportin e Punës të përgjithësuar të Drejtorisë së Inspektoratit për periudhën kohore Janar –Dhjetor 2025.

Në kuadër të Drejtorisë së Inspektoratit funksionojnë këta sektorë:

1. Shefi i Drejtorisë
2. Sektori i Tregut
3. Sektori i Ndërtimit
4. Sektori i mbrojtës së Ambientit
5. Sektori i Komunikacionit
6. Sektori i Shërbimeve Publike

Drejtoria e Inspektoratit gjatë gjithë këtyre muajve ka bërë inspektimin e terrenit në përgjithësi tek të gjithë sektorët.

Gjatë kësaj periudhe jemi angazhuar maksimalisht që detyrat dhe përgjegjësit e tona t'i zbatojmë dhe njëkohësisht ti përfundojmë me përpikëri dhe në afat kohor optimal.

Kemi bërë planifikimin e punëve për drejtori për vitin 2025, kemi bërë vlerësimin e punëtorëve për vitin 2024, kemi bërë Raportin e punës për drejtori për vitin 2024 dhe të gjitha këto i kemi dorëzuar tek kryetari.

-Kemi bërë Rekomandim për Drejtorin e Shërbimeve Publike për pastrimin e disa pikave ilegale të mbeturinave inerte dhe komunale pasi që kemi konsideruar që është më urgjente, përkatësisht -Po ashtu kemi bërë edhe disa kërkesa tjera për disa pika tjera për pastrim të mbeturinave kryesisht të mbeturinave inerte.

-Kemi dërguar Ankesë në Prokurorin e Apelit në Prishtinë për një vendim lidhur me një rast të ndërtimit pa leje ndërtimore.

-Ne bashkëpunim me zyrtar të drejtorisë së Gjeodezisë kemi bërë vendosjen e pikëve gjeodezike të pronës publike në rrugën Skenderbeu përkatësisht objektet përball objektit komunal

-Njëkohësisht në mënyrë vullnetare disa persona përgjegjës të disa lokaleve kanë bërë lirim të hapësirave publike në rrugën "GJ.K-Skenderbeu"

-Pasi që punimet e projektit për parkingjet nëntokësore janë duke u zhvilluar me intensitet më të madh, në koordinim me Drejtorin e Shërbimeve Publike kemi zhvendosur vendparkimin e taxive prej rrugës "Adem Jashari" përkatësisht te stacioni i autobusëve në rrugën "Skenderbeu" për një kohë të përkohshme e që me pastaj përsëri janë kthyer në vend parkimin e mëhershëm

-Pas pranimit të disa shkresave nga Policia e Malishevës edhe këtë vit lidhur me problematiken e qenëve endacak në përgjithësi dhe duke e ditur se kjo dukuri shqetësuese nuk është vetëm në qytetin e Malishevës por edhe nëpër fshatrat e Malishevës si dhe në tërë Kosovën ne kemi bërë konsulta me organet/drejtorit tjera komunale rreth këtij problemi.

-Pas parashtrimit të kërkesave nga disa subjekte afariste kemi inspektuar dhe me këtë rast kemi lëshuar Pëlqime për disa subjekte afariste për plotësimin e kushteve minimale teknike që këto subjekte i plotësojnë për zhvillimin e veprimtarisë afariste.

-Jemi duke inspektuar vazhdimisht ndërtimet të cilat kanë Leje Ndërtimore se a janë duke e respektuar ndërtimet e zhvilluara sipas lejes së dhënë. Zakonisht inspektohet faza e ndërtimit para hedhjes së betonit në pllakë lidhur me respektimin e standardit të ndërtimit/hekurit (armaturës), po ashtu inspektohet edhe faza e betonimit të shtyllave të objekteve si dhe piketimet e objekteve.

-Janë shqyrtuar disa kërkesa të inspektimeve të ndërtimit, në lidhje me respektimin e standardit të ndërtimit.

-Po ashtu inspektime jemi duke bërë për parandalimin e ndërtimeve eventuale pa leje ndërtimore, ku kemi pasur disa raste që investitorë të ndryshëm kanë bërë fillimin e ndërtimit të objekteve pa leje ndërtimore dhe ne kemi bërë ndërprerjen e punimeve të mëtutjeshme të ndërtimit njëkohësisht kemi vendosur paraprakisht shiritat si dhe kemi dërguar lëndet për organet e përgjegjëse të drejtësisë siç është paraparë me legjislacionet në fuqi .

-Kemi marrë pjesë nonstop edhe këtë vit në të gjitha fazat e rrënimin të objekteve me rastin e lirimit të hapësirave publike që është duke u bërë, në Malishevë

-Inspektime të terrenit në tërë territorin e Malishevës janë bërë lidhur me hedhjen e mbeturinave si komunale ashtu edhe inerte.

-Kemi bërë rekomandime të ndryshme kryesisht Drejtorisë së Urbanizmit asaj të Shërbimeve Publike , kompanisë së ujësjellësit lidhur me deblokimin e kanalizimeve si dhe për ndërrim të gypave të kanalizimit komplet në ato vende ku nuk ka mundësi të bëhet deblokimi

-Kemi bërë vërejtje dhe urdhëresa për disa persona përgjegjës të subjekteve afariste për marrjen e pëlqimeve për shfrytëzim të hapësirës në pronën publike në sheshin Ibrahim Mazreku.

-Kemi bërë inspektimin e vijave urbane në përgjithësi për të verifikuar se kompanitë transportuese a janë duke i mbajtur vijat e rregullta urbane të lejuara.

-Po ashtu në kuadër të inspektimeve të transportit rrugor kemi inspektuar edhe për veprimtari ilegale kryesisht për taxit ilegal si dhe veprimtarin e k-taxive pa pëlqime komunale ku në rastet ku kemi hasur duke bërë transport ilegal të udhëtarëve ju kemi shqiptuar gjobë mandatorë.

Aksione/inspektime të herëpashershme në lëmin e trafikut kemi pasur edhe me inspektoret e nivelit qendror të ATK-së

-Edhe këtë vit është inspektuar informalitetin në treg, kryesisht subjekte të cilat janë duke zhvilluar veprimtari afariste ilegale e që në këtë vit ka qenë gjendje shumë e mirë dhe në këtë aspekt, ka pasur shumë pak raste ku kemi hasur në këso subjekte dhe me vërejtjen e dhenë ata janë regjistruar.

-Kemi bërë asgjësimin e mallit në subjekte afarist të mallit ushqimor lidhur me afatin e skadencës dhe mos ruajtjes së mirë të mallit në vlerë prej 1212.⁰⁰ €.

-Është bërë orari i kujdestarisë gjatë gjithë vitit përkatësisht për çdo tre muaj me ndryshime të herë pas herës për barnatoret e qytetit të Malishevës.

-Ja inspektuar shumë subjekte afariste lidhur me kontrollin e mallrave ushqimore për skadencën e afatit, ruajtjen e përgjithshme të mallit, kontrollin e çmimeve kryesisht përputhjen e çmimit të tij raft-arkë

-Janë inspektuar furrat e bukës dhe atë për kontrollin e peshës së deklaruar të bukës.

-Gjithashtu janë inspektuar tregjet javore si ai i automjeteve, i kafshëve si dhe i përgjithshmi (gjelbëri) për mirëvajtjen e përgjithshme të tyre.

-Janë inspektuar të gjitha hapësirat publike në territorin e Malishevës me theks të veçantë janë inspektuar hapësirat jashtme të objekteve publike të institucioneve arsimore, shëndetësorë si dhe hapësirat publike në fshatra, dhe në qytet.

-Është inspektuar gjatë gjithë vitit vazhdimisht hapësira publike në bulevardin Ibrahim Mazreku lidhur me shfrytëzimin e hapësirave publike nga personat përgjegjës të disa subjekteve afariste lidhur me lejimin shfrytëzimit të hapësirës nga subjektet për tavolinat shërbyese në periudhën verore si dhe shërbimet tjera, ku me rastin e inspektimeve kemi pas edhe raste që është bërë tentimi i shfrytëzimit të hapësirave pa pëlqim nga organet komunale dhe kemi bërë eliminimin e tyre.

-Pas disa shkresave të Policisë të cilat kanë qenë të natyrave të ndryshme, ne të gjitha këto shkresa të pranuar dhe njëkohësisht jemi marrë me çështjen e tyre.

-Zyrtar të drejtorisë tonë kanë marrë pjesë në komisione komunale të ndryshme komunale si dhe në komisionin për Përformancë Komunale.

-Janë inspektuar 4 objekte me Leje Ndërtimore të reja të filluara në këtë vit. -

Janë inspektuar 18 objekte të pajisura me Leje Mjedisore Komunale se a po zbatohen-respektohen masat mbrojtëse mjedisore të cekura në raportin mjedisor e që janë respektuar masat mbrojtëse të cekura në raport mjedisor.

➤ Gjatë kësaj periudhe të raportimit, Drejtoria Inspektoratit ka lëshuar :

Procesverbale, Aktvendime, Pëlqime, Vërtetime, shqyrtime të kërkesave-ankesave të natyrave të ndryshme, Gjyba mandatore, Kërkesa për Prokurori, Shkresa/Kërkesa policisë.

Faleminderit !